



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.13/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e paraqitura nga Organizata Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)” me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Ehat Miftaraj (Drejtor Ekzekutiv), dhe subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN TË BAZUARA ankesat e OJQ-së “Instituti i Kosovës për Drejtësi” (IKD), me seli në Prishtinë, ZP.Anr.13/2026 e datës 04.06.2026, dhe ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë ZP.Anr.18/2026, e datës 04.06.2026, ashtu që subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej pese mij (5000) €.

II. DETYROHET Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 04.06.2026, PZAP-i, ka pranuar dy ankesa te identifikuar me numër ZP.Anr.13/2026 të parashtruar nga OJQ “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)” me seli në Prishtinë dhe ZP.Anr.18/2026, të parashtruar nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë.

Në ankesën ZP.Anr.13/2026, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nga OJQ “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)” pretendohet se me datë 03 qershor 2026, IKD ka pranuar informacione se gjatë një tubimi të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) të mbajtur në

po të njëjtën ditë, në Viti, me fillim rreth orës 17:00 në aktivitetin e fushatës është përfshirë aktivisht një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç. IKD ka shikuar video të këtij tubimi, e ku shihet se kryetari i këtij subjekti politik, Lumir Abdixhiku, i jep hapësirë në skenë një vajze, e cila po e njëjta, ngjitet në skenë me flamurin e subjektit politik LDK, ndërsa Abdixhiku i drejtohet publikisht duke i kërkuar që flamurin ta mbajë lart. Pas këtij udhëzimi, vajza vazhdon të qëndrojë në skenë duke ekspozuar flamurin e subjektit politik para pjesëmarrësve të tubimit. Nga pamjet audiovizuale duket të jetë se vajza në fjalë e përfshirë në aktivitet është fëmijë dhe paraqitet si person nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare. Përfshirja e saj nuk konsiston vetëm në praninë fizike në tubim, por në paraqitjen e saj në skenë me simbolin identifikues të subjektit politik dhe sipas udhëzimit të drejtpërdrejtë të kryetarit të këtij subjekti. Madje, derisa vajza mirëpritet në skenë, kryetari i këtij subjekti politik, Abdixhiku, duke iu referuar publikisht vajzës si fëmijë, deklaron: *“Ne fëmijët nuk i shtimë me recitu poezi që ofendojnë të tjerët, ne fëmijët i kemi krenari...”*. Kjo deklaratë dëshmon se përfshirja e fëmijës në skenë ka qenë e njohur dhe e pranuar nga drejtuesi i subjektit politik gjatë zhvillimit të aktivitetit zgjedhor. Për më tepër, fotografitë ku shihet vajza e mitur në skenë me flamurin e LDK-së janë përfshirë edhe në postimin e publikuar nga Lumir Abdixhiku për tubimin e mbajtur në Viti. Duke marrë parasysh të gjitha këto, përfshirja e fëmijës nuk ka mbetur vetëm brenda aktivitetit fizik të tubimit, por është përdorur edhe në komunikimin publik dhe promovues të lidhur me fushatën e subjektit politik.

Andaj, IKD konsideron se subjekti politik LDK ka shkelur Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarinimin financiar. Bëhet fjalë për nenin 5 të kësaj rregullore [*Të drejtat dhe obligimet/ e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve politike*], paragrafin 3, përmes të cilit ndalohet angazhimi i personave nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Ky paragraf përcakton se: *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të bëhet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve”*.

Për më tepër, deklarata publike e kryetarit të LDK-së, përmes së cilës ai i referohet vajzës si fëmijë, dëshmon se subjekti politik ka qenë i vetëdijshëm për përfshirjen e një fëmije në aktivitetin e fushatës. Megjithatë, paraqitja e saj në skenë nuk është ndërprerë; përkundrazi, vajza ka vazhduar të ekspozojë flamurin e LDK-së, ndërsa fotografitë e saj janë përdorur më pas edhe në postimin publik lidhur me tubimin. Rrjedhimisht, rasti konkret nuk mund të trajtohet si paraqitje e rastësishme apo spontane e një fëmije në afërsi të një aktiviteti politik. Përfshirja e saj është mundësuar, udhëzuar dhe më pas publikuar nga përfaqësuesi më i lartë i subjektit politik, në kuadër të një aktiviteti të fushatës zgjedhore. Në këtë drejtim, IKD kërkon nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) që këtë ankesë ta pranojë si të bazuar, të konstatojë se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shkelur nenin 5, paragrafin 3, të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 dhe ndaj të njëjtit subjekt politik të shqiptojë gjobë adekuate dhe proporcionale, duke marrë parasysh natyrën e shkeljes, përfshirjen e drejtpërdrejtë të fëmijës në promovimin vizual të subjektit politik dhe nevojën për parandalimin e praktikave të tilla gjatë fushatave zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: 1. Linkun e video në Facebook <https://www.facebook.com/share/r/IH5ciwtiP/>, (shtojca 1) fotot të shkëputura nga video e njëjtë; 2. Linku

i postimi i Abdiuxhikut- <https://www.facebook.com/share/p/1DpZusE21E/>, fotot e bashkangjiitura (shtojca 2).

Në ankesën ZP.Anr.18/2026, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pretendohet se me datë 3 Qershor 2026, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë identifikuar një shkelje të rregullave të fushatës zgjedhore gjatë një tubimi zgjedhor të organizuar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Nga videoja e publikuar në rrjetet sociale, shihet se gjatë kohës kur kryetari i LDK-së, z. Lumir Abdixhiku, po mbante fjalim para pjesëmarrësve të tubimit, një vajzë e mitur i afrohet skenës duke mbajtur një flamur me logon e LDK-së, Z. Abdixhiku e inkurajon me fjalët: *“Ne fëmijët nuk i shtijmë me recitu poezi që i ofendojnë të tjerët, ne fëmijët i kemi krenari”* Nga pamjet në video shihet se e mitura ndihmohet nga persona të pranishëm për ta shpalosur flamurin, ndërsa më pas ngjitet në skenë dhe afrohet pranë foltores qendrore të aktivitetit dhe valon flamurin në pjesën qendrore të skenës. Z. Abdixhiku e inkurajon duke i thënë *“Mbaje flamurin lart!”*. Veprimi përcillet me duartrokitje nga publiku dhe me ndërveprim të drejtpërdrejtë nga z. Abdixhiku. Neni 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar përcakton se: *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore”*. Në rastin konkret janë përmbushur të gjitha elementet përbërëse të shkeljes së paraparë me nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Së pari, vajza e përfshirë në aktivitet është dukshëm person nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç. Së dyti, pjesëmarrja e saj nuk është kufizuar në prani pasive në publik, por është shëndërruar në pjesëmarrje aktive në aktivitetin zgjedhor. E mitura ngjitet në skenë gjatë kohës sa zhvillohet tubimi zgjedhor, mban dhe valon flamurin e subjektit politik LDK para pjesëmarrësve, ndërvepron drejtpërdrejt me kandidatin për Kryeministër dhe bëhet pjesë e programit të aktivitetit. Për rrjedhojë, nuk bëhet fjalë për një të mitur që thjesht ndodhet në audiencë, por për një të mitur që është përfshirë aktivisht në aktivitetin zgjedhor të subjektit politik. Fakti se vetë z. Abdixhiku, në momentin kur e mitura po afrohej me flamurin e subjektit politik, deklaroi publikisht: *“Ne fëmijët nuk i shtijmë me recitu poezi që i ofendojnë të tjerët, ne fëmijët i kemi krenari”*, kjo deklaratë dëshmon se prania e të miturës nuk ka kaluar pa u vërejtur nga organizatori i aktivitetit, por përkundrazi është pranuar, përshëndetur dhe inkorporuar në zhvillimin e tubimit politik. Prandaj, duke marrë parasysh praninë aktive të të miturës në skenë, përdorimin e simbolikës partiake, ndërveprimin me kandidatin dhe lejin e kësaj pjesëmarrjeje nga organizatorët, rezultojnë se janë përmbushur elementet e shkeljes së përcaktuar në nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024.

PZAP, në vendimin për rastet ZP.Anr.11/2026 dhe ZP.Anr.12/2026, ka konstatuar se lejimi dhe mundësia e pjesëmarrjes së një të mituri në skenë gjatë një aktiviteti zgjedhor përbën përfshirje aktive në fushatë zgjedhore dhe bie në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, Madje, në këtë, rast PZAP ka gjykuar se nuk është me rëndësi nëse ka pasur ftesë, organizim apo koordinim paraprak; rëndësi ka fakti se organizatori e ka lejuar të marrë pjesë në aktivitetin politik. Marrë parasysh këto, kërkojmë nga PZAP që të konstatojë shkeljen nga ana e Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe të shqiptojë sanksionin e përcaktuar nga legjislativi në fuqi. Si provë ka bashkangjitur: Video në CD dhe linku: <https://www.facebook.com/share/t/1MKdy3pLt7/?mibextid=wwXlfr>

Në përgjigje në ankesat e paraqitura, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitura në ankesën e IKD-së dhe të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) si të pabazuara në fakte dhe në të drejtën e aplikueshme. Sipas pretendimeve në përgjigje në ankesë, së pari ankesa nuk arrin të provojë se vajza e përmendur është angazhuar nga LDK-ja në kuptimin e nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Prania e saj në tubim nuk përbën në vetvete angazhim në fushatë zgjedhore. Vajza nuk ka qenë pjesë e strukturave organizative të tubimit, nuk ka pasur asnjë rol të caktuar nga organizatori, nuk ka mbajtur fjalim, nuk ka përcjellë mesazhe politike. Së dyti, pretendimi se ajo është "aktivizuar" nga LDK-ja nuk mbështetet në asnjë provë konkrete. Në asnjë nga provat e paraqitura nuk dëshmohet se subjekti politik ose ndonjë përfaqësues i tij e ka ftuar, angazhuar apo caktuar vajzën për të kryer veprime në kuadër të fushatës zgjedhore. Prania e saj në skenë ka qenë spontane dhe nuk ka qenë rezultat i ndonjë organizimi apo koordinimi nga ana e LDK-së. Për më tepër, LDK-ja ka siguruar deklaratë nga prindi i vajzës, me të cilën konfirmohet se vajza ka marrë pjesë në aktivitet me dijeninë, praninë dhe pëlqimin e plotë të prindit. Në deklaratë theksohet qartë se vajza nuk është ftuar, aktivizuar apo angazhuar nga LDK-ja dhe se nuk ka pasur asnjë rol në organizimin apo zhvillimin e aktivitetit zgjedhor. Edhe vetë përmbytja e provave të paraqitura nga ankuesi nuk dëshmon ndonjë veprim të vajzës që mund të konsiderohet aktivitet zgjedhor. Prania e saj në skenë dhe mbajtja e një flamuri nuk përbëjnë, në vetvete, angazhim në fushatë zgjedhore, veçanërisht kur mungon çdo dëshmi për një rol aktiv politik apo elektorale.

Rrjedhimisht, në rastin konkret mungon elementi thelbësor i angazhimit të një të miture nga subjekti politik, i kërkuar nga neni 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Ankuesi nuk ka provuar se LDK-ja ka organizuar, nxitur apo përdorur vajzën për qëllime të fushatës zgjedhore. Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet se flamuri i mbajtur nga vajza nuk i është dhënë nga kryetari i LDK-së apo nga organizatorët e aktivitetit, por nga prindi i saj, i cili ka qenë i pranishëm gjatë gjithë kohës në tubim.

Po ashtu, pretendimi se kryetari i LDK-së ka angazhuar apo aktivizuar vajzën është i pabazuar. Kryetari i LDK-së nuk e njeh personalisht vajzën, nuk ka pasur asnjë komunikim paraprak me të apo me familjen e saj dhe nuk ka qenë i informuar paraprakisht për praninë e saj në skenë. Për rrjedhojë, mungon çdo element që do të mund të dëshmonte se vajza është përzgjedhur, ftuar apo përdorur nga subjekti politik për qëllime të fushatës zgjedhore. Fakti që një pjesëmarrëse në tubim është gjendur për një periudhë të shkurtër në skenë nuk krijon automatikisht marrëdhënie angazhimi ndërmjet saj dhe subjektit politik. Për të ekzistuar shkëlja e pretenduar, duhet të provohet se subjekti politik ka ndërmarrë veprime aktive për ta përfshirë të miturën në fushatë, gjë që në rastin konkret nuk është dëshmuar me asnjë provë. Për këto arsye, kanë kërkuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës që të refuzojë ankesat lidhur me rastin si të pabazuara në fakte dhe në të drejtë.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.13/2026 dhe ZP.Anr.18/2026, të paraqitura me datë 04.06.2026, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZP.Anr.13/2026, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga Organizata Joqeveritare "Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)" dhe subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër subjektit të njëjtë politik

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore nga ankesa si dhe përgjigjen në ankesë, gjeti se:

- **Ankesat janë të bazuara.**

Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave vëren se nga fotografitë, video-ja dhe linku i ofruara si provë nga parashtuesit e ankesave, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, është konstatuar se në tubimin e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) më datë 03.06.2026, rreth orës 17.00, ka marrë pjesë edhe një fëmijë i mitur , vajzë e cila, ngjitet në skenë dhe mban flamurin e subjektit politik LDK, dhe pas udhëzimit nga kryetari i subjektit politik LDK, vajza vazhdon të qëndrojë në skenë duke ekspozuar flamurin e po të njëjtit subjekt politik para pjesëmarrësve të tubimit, veprim ky që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën është përcaktuar se *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore.”*

Paneli vlerëson se qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e të miturve nga përfshirja në aktivitete të fushatës zgjedhore nga subjektet politike, dhe se në asnjë rrethanë nuk mund të marrin pjesë në aktivitete zgjedhore. *Bazuar në instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përcaktojnë kufijtë e qartë se çdo veprim duhet të jetë në interes të mirë të fëmijëve dhe të mos përdoren fëmijët për propagandë partiake, që të mos përfshihen fëmijët në përhapjen e mesazheve politike apo partiake që ata nuk mund ti kuptojnë përmbajtjen e tyre, që fëmijët mos të përdoren si imazhe për përfitim elektoral.*

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi edhe pretendimet në përgjigje në ankesë të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), se *“...Vajza nuk ka qenë pjesë e strukturave organizative të tubimit, nuk ka pasur asnjë rol të caktuar nga organizatori, nuk ka mbajtur fjalim, nuk ka përcjellë mesazhe politike...”* .Por të njëjtin pretendim e vlerësoi si të pabazuar, për faktin se në momentin kur organizatori i aktivitetit i ka mundësuar të miturës pjesëmarrjen në tubim elektoral, pastaj paraqitjen e saj në skenë me flamur të subjektit LDK-se para publikut në kuadër të tubimit zgjedhor, pjesëmarrja e saj konsiderohet përfshirje aktive në fushatë zgjedhore. Sepse për zbatimin e kësaj norme nuk është vendimtare nëse iniciativa për paraqitjen e të miturës ka ardhur nga organizatori apo nga vetë e mitura, por vet fakti se subjekti politik ka lejuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e saj aktive, në një aktivitet zyrtar zgjedhor.

Lidhur me pretendimin nga përgjigja në ankesë se *“Në asnjë nga provat e paraqitura nuk dëshmohet se subjekti politik ose ndonjë përfaqësues i tij e ka ftuar, angazhuar apo caktuar vajzën për të kryer veprime në kuadër të fushatës zgjedhore...”* Këto pretendime paneli i vlerësoi si të pabazuar, për faktin se nuk është më rëndësi në këtë rast se a ka pasur ftesë, organizim apo koordinim për të marrë pjesë e mitura në aktivitete politik, por me rëndësi është fakti se organizatori i këtij aktiviteti e ka lejuar që e mitura të marrë pjesë në këtë aktivitet politik, duke i dhënë rol aktiv në promovim të këtij subjekti politik duke e nxitur të mbaj me lart flamurin me logon e këtij subjekti politik, veprim ky i cili bije në kundërshtim me Rregulloren e sipërcituar.

Lidhur me pretendimin nga përgjigja në ankesë se “Për më tepër, LDK-ja ka siguruar deklaratë nga prindi i vajzës, me të cilën konfirmohet se vajza ka marrë pjesë në aktivitet me dijeninë, praninë dhe pëlqimin e plotë të prindit. Në deklaratë theksohet qartë se vajza nuk është ftuar, aktivizuar apo angazhuar nga LDK-ja dhe se nuk ka pasur asnjë rol në organizimin apo zhvillimin e aktivitetit zgjedhor.” Paneli vlerëson se është i parëndësishëm fakti se prindi i saj nuk e ka kundërshtuar pjesëmarrjen e saj në tubim, por rëndësishëm është fakti se e mitura në asnjë rrethanë nuk ka mundur të gjendet në atë aktivitet politik, e aq më shumë të paraqitet para pjesëmarrësve në tubim, të mbaj flamurin të partisë politike, dhe të deklarohet nga kryetari i subjektit politik LDK gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore se “Ne fëmijët nuk i shtimë me recitu poezi që ofendojnë të tjerët, ne fëmijët i kemi krenari”, ngase ky veprim si u tha më lartë bije në kundërshtim me rregullat zgjedhore.

Në këtë kuptim, për Panelin këto veprime janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Paneli me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit më gjobë si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: se përfshirja e fëmijëve në fushata zgjedhore përbenë shkelje të drejtave të tyre, dhe se nuk është në interesin më të mirë të tyre që subjektet politike të angazhohen në fushata zgjedhore, po ashtu paneli ka vlerësuar natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, dhe se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Mbi këtë bazë, e duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e subjekteve ankuese janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa nga parashtruesit e ankesave paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, të rregullës zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara më lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.13/2026, datë 05.06.2026

Kryesuese e Panelit
Kymete Kica



Këshillë Juridike: kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjin Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.